

**PROJEKT-MARRËVESHJE PËR BASHKIMIN ME PËRTHITHJE TË SHOQËRIVE  
“MET INVEST” SHPK DHE “NEW START” SHPK**

Kjo Projekt-Marrëveshje nënshkruhet sot më Datë 08.07.2019 në Tiranë, ndërmjet Palëve të mëposhtme:

**Shoqëria “Met Invest” Shpk**, e themeluar më Datë 10.01.2018 në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë, me NIPT L81310039M, me Seli në Adresën Rruga “Lekë Dukagjini”, Pallati 11, Kati 2, Tiranë, Përfaqësuar nga Administratori i saj Z.Hauard Malo, këtu e në vijim referuar si **“Shoqëria Përthithëse”**.

Dhe

**Shoqëria “New Start” Shpk**, e themeluar më Datë 12.06.2013 në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë, me NIPT L31812011A, me Seli në Adresën Rruga “Papa Gjon Pali”, Pallati 11, Kati 2, Tiranë, Përfaqësuar nga Administratori i saj Z.Enklajd Malo, këtu e në vijim referuar si **“Shoqëria e Përthithur”**.

Palët bien dakort për sa më poshtë vijon:

**1. PËRKUFIZIMET DHE INTERPRETIMET**

Në këtë Projekt-Marrëveshje (përfshirë edhe anekset bashkëlidhur), fjalët e mëposhtme kanë këto kuptime:

**“Projekt –Marrëveshje”** do të thotë kjo Projekt-Marrëveshje Bashkimi me Përthithje, duke përfshirë si pjesë integrale të saj edhe anekset bashkëngjitur kësaj, të cilat janë nënshkruar nga Shoqëritë “Met Invest” Shpk dhe “New Start” Shpk.

**“Mbyllje”** do të thotë pranimi i të gjitha kushteve të Projekt-Marrëveshjes së Bashkimit me Përthithje dhe nënshkrimi e miratimi i kësaj të fundit në Asambletë e Ortakëve të të dy Shoqërive të përfshira në bashkim, në përputhje me Pikën 1 të Nenit 218 të Ligjit Tregtar.

**“Data e Mbylljes”** do të thotë Data në të cilën do të kryhet mbyllja, pra data më e vonshme ndërmjet datës së vendimit të asamblesë së Shoqërisë “Met Invest” Shpk dhe Shoqërisë “New Start” Shpk përmes së cilës është miratuar Projekt-Marrëveshja e Bashkimit.

**“Ligji Tregtar”** do të thotë Ligji Nr.9901, Datë 14.04.2008 *“Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”* i ndryshuar.

**“Data e Ekzekutimit”** do të thotë data e regjistrimit të mbylljes në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit. Në këtë Datë Shoqëria e përthithur nuk do të ekzistojë më si subjekt i mëvetësishëm i së drejtës, me personalitet të vecantë juridik, por do të jetë “shkrirë” brenda Shoqërisë Përthithëse.

**“Data e Fundit Kontabël”** do të thotë Data 30.04.2019 ose 31.12.2019 në rast se Bashkimi me Përthithje nuk është realizuar deri më Datë 30.04.2019.

**“Periudhë Tranzitore”** do të thotë periudha kohore nga data e nënshkrimit të kësaj Projekt Marrëveshje deri në regjistrimin në Qendrën e Regjistrimit të Biznesit të procesit

të Bashkimit me Përthithje (data e ekzekutimit), gjatë së cilës Shoqëritë “Met Invest” Shpk dhe “New Start” Shpk do të kryejnë një tërësi veprimesh me qëllim transferimin e të drejtave, detyrimeve dhe asetëve të Shoqërisë “New Start” Shpk te Shoqëria “Met Invest” Shpk.

**“Aktivet dhe Pasivet e Transferuara”** do të thotë të gjitha aktivet dhe pasivet e transferuara nga Shoqëria e përthithur (“New Start” Shpk) te Shoqëria Përthithëse (“Met Invest” Shpk), sic është përcaktuar në këtë Projekt-Marrëveshje.

**“Balanci i Celjes”** do të thotë bilanci i Shoqërisë Përthithëse (“Met Invest” Shpk) pas konsolidimit të Shoqërive “Met Invest” Shpk dhe “New Start” Shpk në Datën e Fundit Kontabël dhe pasqyrimin në të të cdo ndryshimi të mundshëm të ndodhur mes Datës së Fundit Kontabël dhe Datës së Mbylljes së Bashkimit me Përthithje.

Cdo dokument bashkëlidhur kësaj Projekt-Marrëveshje, duke përfshirë Anekset e saj, përbën pjesë integrale të kësaj Projekt-Marrëveshje dhe ka të njëjtën fuqi ligjore dhe efekt si vetë Projekt-Marrëveshja.

## **2. OBJEKTI I PROJEKT-MARRËVESHJES**

Objekti i kësaj Projekt-Marrëveshje është bashkimi përmes përthithjes i Shoqërisë “New Start” Shpk nga Shoqëria “Met Invest” Shpk.

Kjo Projekt-Marrëveshje hartohet në përputhje me kërkesat e Pikës 1 të Nenit 216 të Ligjit Tregtar si dhe Vendimeve të Asambleve të marra nga Shoqëria Përthithëse dhe ajo e Përthithur. Vendimet e Asamblesë janë pjesë integrale e kësaj Projekt-Marrëveshje.

Në përputhje me Pikën 1 të Nenit 215 të Ligjit Tregtar, Shoqëria “New Start” Shpk do të transferojë me anë të bashkimit me përthithje të gjitha aktivet dhe pasivet që zotëron, tek Shoqëria Përthithëse “Met Invest” Shpk, në këmbim të kuotave të kësaj të fundit.

Bazuar në Nenin 220, Paragrafi 3 të Ligjit Tregtar, pas regjistrimit të Bashkimit me Përthithje në Qëndrën Kombëtare të Biznesit, Shoqëria “New Start” Shpk do të vlerësohet e prishur dhe do të ç’regjistrohet nga Regjistri Tregtar.

## **3. BILANCET NË MBYLLJE DHE BILANCI I CELJES SË BASHKIMIT ME PËRTHITHJE**

Bashkimi me Përthithje do të bazohet në pasqyrat financiare të Shoqërive “New Start” Shpk dhe “Met Invest” Shpk të Datës 30.04.2019 (Data e Fundit Kontabël) si dhe cdo ndryshim në pozicionin financiar të Shoqërive deri në Datën e Mbylljes. Bazuar në Pikën 5 të Vendimit Nr.2, Datë 03.05.2019 të Shoqërisë “Met Invest” Shpk dhe Pikës 5 të Vendimit Nr.2, Datw 03.05.2019 të Shoqërisë “New Start” Shpk, ndryshimet në pozicionin financiar të Shoqërive “Met Invest” Shpk dhe “New Start” Shpk, pas Datës së Fundit Kontabël, nuk ka nevojë të miratohen nga Asambletë e Përgjithshme të Shoqërive “New Start” Shpk dhe “Met Invest” Shpk në një mbledhje asambleje të ndryshme nga ajo e Datës 29.08.2019. Pra cdo ndryshim në pozicionin financiar të Shoqërive pjesëmarrëse në bashkim pas datës 30.04.2019, do paraqitet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjet e asambleve të Shoqërive “New Start” Shpk dhe “Met Invest” Shpk, të Datës 29.08.2019 dhe jo në një mbledhje mëvete përpara kësaj date.

Bilanci i Celjes së Shoqërisë Përthithëse ("Met Invest" Shpk) do të bazohet në bilancin e konsoliduar të Datës 30.04.2019 të të dy Shoqërive përpara përthithjes.

Në rast se Data e Ekzekutimit (regjistrimit në QKB të Bashkimit me Përthithje) do të jetë më e vonshme se Data 31.12.2019, atëherë Data e Fundit Kontabël do të konsiderohet Data 31.12.2019 dhe të gjitha ndryshimet në zërat e pasqyrave financiare të ndodhura deri në këtë Datë, duhet të reflektohen në këtë Projekt -Marrëveshje dhe në Bilancin e Celjes së Shoqërisë Përthithëse.

Pasqyrat e Pozicionit Financiar të të dy Shoqërive deri në Datën e Fundit Kontabël i bashkëngjiten kësaj Projekt-Marrëveshje dhe konsiderohen pjesë integrale e saj.

#### **4. AKTIVET DHE PASIVET E TRANSFERUARA**

Në mbështetje të Pikës 1 të Nenit 215 të Ligjit Tregtar, Shoqëria "New Start" Shpk (Shoqëria e Përthithur) do t'i transferojë Shoqërisë "Met Invest" Shpk (Shoqëria Përthithëse), kundrejt kuotave të kësaj të fundit, të gjitha aktivet dhe pasivet sipas Bilancit të Datës së Fundit Kontabël, duke marrë në konsideratë edhe cdo ndryshim të ndodhur deri në Datën e Mbylljes së Bashkimit me Përthithje.

Aktivet dhe Pasivet përfshijnë cdo të drejtë dhe detyrim të njohur si të tillë në pasqyrat financiare, bazën e të dhënave të klientëve, listën e proceseve gjyqësore të papërfunduara me vendim gjyqësor të formës së prerë deri në Datën e Ekzekutimit të Mbylljes dhe çdo marrëdhënie tjetër kontraktore.

Aktivet dhe detyrimet tatimore të Shoqërisë "New Start" Shpk (Shoqëria e Përthithur), sic rezultojnë në pasqyrat financiare të Datës së Fundit Kontabël, do t'i transferohen Shoqërisë "Met Invest" Shpk si të gjitha llojet e tjera të aktiveve dhe detyrimeve.

Me transferimin e aktiveve dhe detyrimeve, Shoqëria "Met Invest" Shpk do të marrë në posedim të gjitha evidencat, librat, korrespondencat, regjistrimet, projekt-marrëveshjet dhe dokumenta të tjera për të provuar ekzistencën e të drejtave dhe detyrimeve që transferohen.

Kur për transferimin e aktiveve/detyrimeve të caktuara nevojitet miratimi i një pale të tretë, do të merret paraprakisht ky miratim. Deklarata e palëve të treta që lejojnë Bashkimin me Përthithje do të jetë pjesë e dokumentacionit që do të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në Datën e Ekzekutimit.

Për pasuritë e paluajtshme në pronësi të Shoqërisë "New Start" Shpk (Shoqëria e Përthithur), nga Data e Miratimit të kësaj Projekt-Marrëveshje Bashkimi ose nga Data e Ekzekutimit (cilado qoftë data më e hershme), Shoqëria "Met Invest" Shpk (Shoqëria Përthithëse) do të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për regjistrimin e këtyre në pasurive në emrin e saj, në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Me transferimin e të drejtave, aktiveve dhe detyrimeve nga Shoqëria e Përthithur te Shoqëria Përthithëse, kjo e fundit do të gëzojë të drejtën për të ngritur pretendime ligjore ndaj këtyre aktiveve si dhe do të mbart detyrimin për t'u përgjigjur ndaj pretendimeve që mund të ngrenë palë të treta.



3 | Page

Të drejtat dhe detyrimet që Shoqëritë “Met Invest” Shpk dhe “New Start” Shpk kanë kundrejt njëra tjetrës shuhen në Bilancin e Celjes së Shoqërisë Përthithëse.

## **5. RAPORTI I KËMBIMIT TË KUOTAVE DHE KUOTAT E SHOQËRISË PËRTHITHËSE**

### **5.1 Struktura e Kapitalit të Regjistruar të Shoqërive të përfshira në Bashkim dhe rrethi Ortakëve të secilës prej tyre.**

**Shoqëria “New Start” Shpk (Shoqëria e Përthithur)** ka një Kapital të Regjistruar prej 100.000 (njëqind mijë) Lekësh. Vlera e Kapitalit të Regjistruar është në të holla dhe është shlyer tërësisht nga Ortakët në kohën e themelimit të Shoqërisë. Kapitali i Regjistruar i Shoqërisë është i ndarë në 5 (pesë) kuota të cilat zotërohen nga ortakët e mëposhtëm të Shoqërisë, në këto raporte:

Enklajd Malo, zotëron një kuotë e cila përfaqëson 20% të Kapitalit të Regjistruar të Shoqërisë, përkthyer në një vlerë prej 20.000 (njëzet mijë) Lekë.

Hauard Malo, zotëron një kuotë e cila përfaqëson 20% të Kapitalit të Regjistruar të Shoqërisë, përkthyer në një vlerë prej 20.000 (njëzet mijë) Lekë.

Migena Malo, zotëron një kuotë e cila përfaqëson 20% të Kapitalit të Regjistruar të Shoqërisë, përkthyer në një vlerë prej 20.000 (njëzet mijë) Lekë.

Miranda Malo, zotëron një kuotë e cila përfaqëson 20% të Kapitalit të Regjistruar të Shoqërisë, përkthyer në një vlerë prej 20.000 (njëzet mijë) Lekë.

Perla Malo, zotëron një kuotë e cila përfaqëson 20% të Kapitalit të Regjistruar të Shoqërisë, përkthyer në një vlerë prej 20.000 (njëzet mijë) Lekë.

**Shoqëria “Met Invest” Shpk (Shoqëria Përthithëse)** ka një Kapital të Regjistruar prej 100.000 (njëqind mijë) Lekësh. Vlera e Kapitalit të Regjistruar është në të holla dhe është shlyer tërësisht nga Ortakët në kohën e themelimit të Shoqërisë. Kapitali i Regjistruar i Shoqërisë është i ndarë në 5 (pesë) kuota të cilat zotërohen nga ortakët e mëposhtëm të Shoqërisë në këto raporte:

Enklajd Malo, zotëron një kuotë e cila përfaqëson 20% të Kapitalit të Regjistruar të Shoqërisë, përkthyer në një vlerë prej 20.000 (njëzet mijë) Lekë.

Hauard Malo, zotëron një kuotë e cila përfaqëson 20% të Kapitalit të Regjistruar të Shoqërisë, përkthyer në një vlerë prej 20.000 (njëzet mijë) Lekë.

Migena Malo, zotëron një kuotë e cila përfaqëson 20% të Kapitalit të Regjistruar të Shoqërisë, përkthyer në një vlerë prej 20.000 (njëzet mijë) Lekë.

Miranda Malo, zotëron një kuotë e cila përfaqëson 20% të Kapitalit të Regjistruar të Shoqërisë, përkthyer në një vlerë prej 20.000 (njëzet mijë) Lekë.

Perla Malo, zotëron një kuotë e cila përfaqëson 20% të Kapitalit të Regjistruar të Shoqërisë, përkthyer në një vlerë prej 20.000 (njëzet mijë) Lekë.

## 5.2 Raporti i Këmbimit të Kuotave dhe Kuotat e Shoqërisë Përthithëse

Sic rezulton nga sa më sipër, rrethi i Ortakëve në të dy shoqëritë e përfshira në bashkim është i njëjtë. Procesi i Bashkimit me Përthithje të Shoqërisë “New Start” Shpk nga Shoqëria “Met Invest” Shpk do të sjelli si pasojë zmadhimin e Kapitalit të Regjistruar të Shoqërisë “Met Invest” Shpk, si më poshtë:

Kapitali i Regjistruar i Shoqërisë “Met Invest” Shpk (Shoqëria Përthithëse)	
Kapitali i Regjistruar përpara Bashkimit	Kapitali i Regjistruar pas Bashkimit
100.000 Lekë	200.000 Lekë

Duke qënë se rrethi i ortakëve të shoqërive të përfshira në Bashkim është i njëjtë, Ortakët e Shoqërisë së Përthithur, në këmbim të kalimit të të drejtave, asetëve dhe detyrimeve të Shoqërisë së Përthithur te Shoqëria Përthithëse, nuk do të marrin kuota të reja në Shoqërinë Përthithëse. Kjo do të thotë që kapitali i regjistruar i Shoqërisë Përthithëse nuk do të ndahet në kuota të reja, pasi në të nuk hyjnë ortak të rinj.

Në këtë rast, duke qënë se Kapitali i Regjistruar i Shoqërisë Përthithëse do të zmadhohet si pasojë e përthithjes prej saj të Shoqërisë “New Start” Shpk, Ortakët e Shoqërisë së Përthithur do të gëzojnë te Shoqëria Përthithëse një kuotë, vlera e së cilës do të jetë më e madhe se ajo përpara bashkimit, e konkretisht:

Vlera e Kuotës së Secilit Ortak të Shoqërisë “Met Invest” Shpk (Shoqëria Përthithëse)			
Vlera e Kuotës të Secilit Ortak përpara Bashkimit		Vlera e Kuotës të Secilit Ortak pas Bashkimit	
Enklajd Malo	20% të Kapitalit të Regjistruar =20,000 Lekë	Enklajd Malo	20% të Kapitalit të Regjistruar =40,000 Lekë
Hauard Malo	20% të Kapitalit të Regjistruar =20,000 Lekë	Hauard Malo	20% të Kapitalit të Regjistruar =40,000 Lekë
Migena Malo	20% të Kapitalit të Regjistruar =20,000 Lekë	Migena Malo	20% të Kapitalit të Regjistruar =40,000 Lekë
Miranda Malo	20% të Kapitalit të Regjistruar =20,000 Lekë	Miranda Malo	20% të Kapitalit të Regjistruar =40,000 Lekë
Perla Malo	20% të Kapitalit të Regjistruar =20,000 Lekë	Perla Malo	20% të Kapitalit të Regjistruar =40,000 Lekë

## 6. KUSHTET E EKZEKUTIMIT TË BASHKIMIT

Përfundimi i plotë i procesit të përthithjes i nënshtrohet përmbushjes së kushteve të mëposhtme:

- Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë “Met Invest” Shpk dhe Shoqërisë “New Start” Shpk të ketë miratuar me vendim këtë Projekt-Marrëveshje Bashkimi me Përthithje, në përputhje me Pikën 1 të Nenit 218 të Ligjit Tregtar.
- Kur për transferimin e të drejtave, asetëve ose detyrimeve të posaçme të Shoqërisë “New Start” Shpk, duhet miratimi i një pale të tretë, kalimi i tyre te Shoqëria “Met Invest” Shpk nuk mund të bëhet pa miratimin me shkrim të kësaj pale. Deklarata e palëve të treta që lejojnë Bashkimin me Përthithje do të jetë pjesë e dokumentacionit që do të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në Datën e Ekzekutimit.



5 | Page

- Kur për transferimin e të drejtave, asetëve ose detyrimeve të posaçme të Shoqërisë “New Start” Shpk, vec Marrëveshjes së Bashkimit me Përthithje, ligji kërkon edhe nënshkrimin e një akti notarial ndërmjet Shoqërive të përfshira në proces, atëhere kalimi i tyre nuk mund të bëhet pa nënshkrimin e aktit notarial përkatës.

## **7. TË DREJTA TË VECANTA**

Të gjitha kuotat e Kapitalit të Regjistruar të Shoqërisë së Përthithur i japin zotëruesve të tyre (ortakëve të Shoqërisë) të drejta të njëjta dhe të barabarta. Asnjë prej kuotave nuk i jep ortakut/ortakëve, të drejta të vecanta lidhur me aspekte të tilla si përparësi në ndarjen e fitimeve, përparësi në ndarjen e pasurive të shoqërisë të mbetura pas likuidimit të saj apo të drejta të tjera të vecanta.

E njëjta gjë vlen edhe për kuotat e Kapitalit të Regjistruar të Shoqërisë Përthithëse.

Në këto kushte, nuk kemi të drejta të vecanta të ortakëve të Shoqërisë së Përthithur, me qëllim për t'u transferuar në Shoqërinë Përthithëse dhe as të drejta të vecanta të Ortakëve të Shoqërisë Përthithëse, me qëllim për t'u ruajtur/respektuar pas procedurës së bashkimit me përthithje.

## **8. EFEKTET MBI PUNËMARRËSIT**

Në Datën e regjistrimit të bashkimit me përthithje në Qendrën Kombëtare të Biznesit, të gjitha kontratat e punës të punëmarrësve të Shoqërisë “New Start” Shpk, do të transferohen te Shoqëria “Met Invest” Shpk, në përputhje me Nenin 138 dhe 139 të Kodit të Punës.

Shoqëria “Met Invest” Shpk do të konsiderohet pala përgjegjëse për cdo detyrim të pashlyer nga Shoqëria “New Start” Shpk para Datës së Ekzekutimit.

## **9. EFEKTET E BASHKIMIT ME PËRTHITHJE MBI SELINË DHE ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË “MET INVEST” SHPK**

Datën e Ekzekutimit, Selia e Shoqërisë “Met Invest” Shpk mbetet po ajo si përpara bashkimit me përthithje.

Si në rastin e Shoqërisë së Përthithur ashtu edhe në rastin e Shoqërisë Përthithëse, struktura drejtuese e Shoqërive përbëhet nga një organ i vetëm, Administratori i Shoqërisë.

Bashkimi me Përthithje nuk do të sjelli asnjë ndryshim në organet drejtuese të Shoqërisë “Met Invest” Shpk. Në Datën e Ekzekutimit të Bashkimit, Administrator i Shoqërisë “Met Invest” Shpk do të vazhdojë të jetë Z.Hauard Malo. Administratori i Shoqërisë “New Start” Shpk, Z.Enklajd Malo, do të japi dorëheqjen në Datën e Ekzekutimit.



6 | Page

## **10. EFEKTET LIGJORE TË BASHKIMIT ME PËRTHITHJE**

Në përputhje me parashikimet e Nenit 220, Pika 3 e Ligjit Tregtar, regjistrimi i bashkimit të Shoqërive pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit do të ketë si pasojë:

- Kalimin të Shoqëria Përthithëse të të gjitha aktiveve të Shoqërisë së Përthithur.
- Duke qënë se Ortakët e Shoqërisë Përthithëse janë të njëjtë me Ortakët e Shoqërisë së Përthithur, këta të fundit përfitojnë të Shoqëria Përthithëse një kuotë vlere e së cilës është më e madhe se ajo që zotëronin përpara bashkimit. Vlora e kuotës së ortakëve të Shoqërisë Përthithëse rritet si pasojë e rritjes së kapitalit të regjistruar të kësaj të fundit, pas Bashkimit me Përthithje.
- Shoqëria që përthithet vlerësohet e prishur dhe ç'regjistrohet nga Qendra Kombëtare e Biznesit, pa kaluar në procedurë likuidimi.

## **11. MBROJTJA E KREDITORËVE**

Kreditorët e Shoqërisë së Përthithur mbrohen në përputhje me Nenin 221 të Ligjit Tregtar.

## **12. ZGJIDHJA E PROJEKT-MARRËVESHJES**

Kjo Projekt-Marrëveshje mund të zgjidhet në cdo kohë përpara datës së ekzekutimit, me miratimin e dhënë me shkrim nga të dyja palët.

## **13. LIGJI I ZBATUESHËM DHE FORCA MADHORE**

Kjo Projekt-Marrëveshje do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

Palët nuk mund të konsiderohen përgjegjëse për mospërbushjen e detyrimeve që kanë ndaj njëra tjetrës në bazë të kësaj Projekt-Marrëveshje, kur kanë qënë nën ndikimin e një force madhore e cila ndikuar drejtpërdrejtë në ekzekutimin dhe mbarëvajtjen normale të përmbajtjes së kësaj Projekt-Marrëveshje, për aq kohë sa do të vazhdojnë të jenë nën ndikimin e kësaj force dhe për aq sa janë prekur/penguar në ekzekutimin e të drejtave dhe detyrimeve të Projekt-Marrëveshjes.

Forcë madhore do të konsiderohen të gjitha faktet dhe rrethanat që dalin jashtë kontrollit normal dhe të arsyeshëm të palëve dhe kanë ndikuar objektivisht në zbatimin e kësaj Kontrate ose pjesëve të caktuara të saj.

Në konceptin e Forcës Madhore përfshihen pa u kufizuar, turbullirat civile, lufta, grevat, katastrofat natyrore, cdo lloj akti ligjor dhe nënligjor i miratuar pas nënshkrimit të kësaj Kontrate dhe që ndikon drejtpërdrejtë në ekzekutimin normal të kësaj Projekt-Marrëveshje.

## **14. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE DHE GJYKATA KOMPETENTE**

Palët do të bëjnë të gjitha përpjekjet për zgjidhjen me mirëkuptim të mosmarrëveshjeve që mund të lindin nga interpretimi dhe/apo ekzekutimi i kësaj Projekt-Marrëveshje.

Në qoftë se mirëkuptimi sipas paragrafit të parë të këtij neni nuk mund të arrihet, autoriteti kompetentë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

## 15. TË NDRYSHME

- **Shpenzimet:**  
Shoqëria “Met Invest” Shpk do të marri përsipër të gjitha shpenzimet që lidhen me negociimin, nënshkrimin, noterizimin dhe auditimin e cdo dokumenti ligjor apo financiar të nevojshëm për përthithjen.
- **Ndryshime në Projekt-Marrëveshje:**  
Cdo ndryshim i kësaj Projekt-Marrëveshje do të jetë i vlefshëm vetëm nëse është bërë me shkrim dhe është nënshkruar nga të dyja palët.
- **Pavlefshmëria e Pjesshme:**  
Në rast se një pjesë e kësaj Projekt-Marrëveshje është ose shpallet e pavlefshme, pjesa tjetër e saj konsiderohet e vlefshme dhe detyruese për palët.
- **Gjuha e Hartimit të Projekt-Marrëveshjes:**  
Kjo Projekt-Marrëveshje hartohet në gjuhën shqipe.

## 16. LISTA E ANEKSEVE

- Aneksi 1-Vendimet e Asambleve të Ortakëve të Shoqërive “New Start” Shpk dhe “Met Invest” Shpk.
- Aneksi 2- Pasqyrat e Pozicionit Financiar të Datës së Fundit Kontabël të Shoqërisë “New Start” Shpk.
- Aneksi 3- Pasqyrat e Pozicionit Financiar të Datës së Fundit Kontabël të Shoqërisë “Met Invest” Shpk.
- Aneksi 4 – Pasqyra e Pozicionit Financiar të Shoqërisë “Met Invest” Shpk pas Bashkimit me Përthithje.
- Aneksi 5 - Struktura e Re e Aksionarëve të Shoqërisë “Met Invest” Shpk pas Bashkimit me Përthithje.

SHOQËRIA “MET INVEST” SHPK  
Përfaqësues Ligjor  
HAUARD MALO



SHOQËRIA “NEW START” SHPK  
Përfaqësues Ligjor

